REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 919/20
Datë/Datum. 02.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr.919/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi -Kryetar z. Blerim Dina -Referues z. Goran Milenkovic -Anëtar ,si dhe duke u bazuar në nenin 28 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, dhe nr. të protokollit 83/20 të dt: 03.03.2020, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 24 NËNTOR 2020, të parashtruar nga operatori ekonomik N.P.SH "DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc, për tërheqje të ankesës me numër 919/20 të datës 11.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore ne objektet e IEA-së" me nr te prok: 613-20-6118-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-LIPJAN" me datën 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, kërkesa e datës 24 NËNTOR 2020 e operatorit ekonomik "DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc, për tërheqje të ankesës me numër 919/20 të datës 11.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore ne objektet e IEA-së" me nr te prok: 613-20-6118-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-LIPJAN".

II.NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik: "DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc, pasi që ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me numër 919/20 të datës 11.11.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore ne objektet e IEA-së" me nr te prok: 613-20-6118-2-2-1 .

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse parashtruesi i ankesës tërhiqet nga ankesa pas pranimit te raportit te ekspertit shqyrtues, në pajtim me nenin 28 të Rregullores së punës së OSHP-së, nr. 01/20 me numër te protokollit 83/20, këtij OE i bëhet konfiskimi i tarifës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc, ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 11.11.2020, me nr. 919/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore ne objektet e IEA-së" me nr te prok: 613-20-6118-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-LIPJAN" duke pretenduar se AK-ja, ka bërë shkelje të dispozitave Nenin 1, 2, 3, 4, 5, 6, dhe nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik te Republikës së Kosovës.

Me datën 11.11.2020, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja, për pranimin e ankesës së lartpërmendur në mënyre që të behet pezullimi i aktivitet të prokurimit në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datën 13.11.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues me datën: 24.11.2020, ka dorëzuar raportin e ekspertizës me konstatimet si me poshtë:

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Eksperti Shqyrtues vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara në ankese sepse në cilën do mënyrë qe do te vepronte Autoriteti Kontraktuese do të krijonte favore për OE tëcaktuar sepse nuk mund të behet poentomi i çmimeve kur një OE nuk ka çmim në një porcion i cili nuk është dashur të ketë njësi , ndërsa tjetri ofron çmim.

Pra thjesht pozicionet në paramane dhe parollagari nr .35 dhe 50 kanë qenë pozicione që nuk është dashur të keni njësi, ndërsa vetëm për nën pozicionet është dashur të ofrohen çmimet dhe kjo në fakt ka shkaktuar paqartësi gjatë ofertimit, pra përshkrimi i artikujve nuk mund të ketë çmim, dhe AK nuk ka mundur ti poentoj çmimet në mënyrë të drejtë.

Asnjeri nga OE nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tyre për të kërkuar sqarime nga AK në mënyrë që lëshimet e tilla të korrigjohen sepse një gjë e tille nuk mund të korrigjohet në fazën e vlerësimit te ofertave dhe anulimi i tenderit është zgjidhja e vetme.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së pasi që është e pamundur të bëhen korrigjime në fazën e vlerësimit.

Operatori Ekonomik me dt 27.11.2020 përmes emailit ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me Mendimin e Ekspertit Shqyrtues dhe tërhiqet nga Ankesa me nr. 919/20 të datës 11.11.2020.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,njoftimi për kontratë , ankesa e operatorit ekonomik,si dhe Raportin e Ekspertit Shqyrtues , kërkesën e OE ankues te datës 24.11.2020 dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se "DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc më datën 24.11.2020, përmes e-mail-it ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës së datës 11.11.2020, me nr. protokolli 919/20, lidhur me tenderin me titull: "Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore ne objektet e IEA-së" me nr te prok: 613-20-6118-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-LIPJAN".

Paneli shqyrtues pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, konstatoj se kërkesa e OE ankues për tërheqje nga ankesa me numër te protokollit 919/20, është dorëzuar në OSHP me datën 24.11.2020, periudhe kjo kohore në te cilën eksperti shqyrtues i prokurimit ka Publikuar Ekspertizën duke i shqyrtuar të Gjitha pretendimet Ankimore.

Andaj OSHP aprovon kërkesën e OE ankues për tërheqje nga ankesa, dhe në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20, ankuesit i behet konfiskimi i tarifës lidhur me ankesën me numër të protokollit 919/20 të datës 11.11.2020, nga fakti se ankuesi ka bere kërkesë për tërheqje nga ankesa pas pranimit të raportit të ekspertizës ndërsa neni 28 paragrafi 1 i Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20 specifikon:Pala mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë. Në rast se ankesa tërhiqet para shqyrtimit të ankesës dhe/ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para pranimit të akt-ekspertizës, do të bëhet kthimi i tarifës së ankesës. Në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit shqyrtues dhe pranimit të akt-ekspertizës atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale.

Paneli shqyrtues i OSHP-së, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, të njëjtën e aprovoj si të bazuar, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi i dërgohet:

1x1 AK-"KK-LIPJAN" .

1x1 OE-"DONI TERM" Gafurr Jashari B.I -Gllogoc

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim ne web faqe të OSHP-së.